



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Raporti i përmbushjes së obligimeve të komunave
nga Agjenda Evropiane për periudhën
Janar – Dhjetor 2024



Prishtinë, 2025

Përmbajtja

Shkurtesat	3
Hyrje	4
Përmbledhje Ekzekutive.....	5
1. KRITERET POLITIKE	7
1.1 Administrata Publike.....	7
1.2 Shoqëria civile	9
1.3 Lufta kundër korrupsionit dhe kundër terrorizmit	9
1.4 Mbrojtja dhe trashëgimia kulturore	11
2. KRITERET EKONOMIKE	12
2.1 Ekzistenca e ekonomisë funksionale e tregut.....	12
2.2 Tatimet.....	13
2.3 Ndërmarrjet dhe politikat e industrisë	13
3. STANDARDET EVROPIANE	14
3.1 Bujqësia dhe zhvillimi rurale	14
3.2 Energjia	15
3.3 Mbrojtja e minoriteteve.....	20
3.4 Drejtësia, liria dhe siguria,	20
3.5 Menaxhimi i kufirit dhe migracioni	20
REKOMANDIMET.....	24

Shkurtesat

BE	Bashkimi Evropian
EVS	Ekipet Vepruese për Siguri
KE	Komisioni Evropian
KKSB	Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi
KLSP	Këshillat Lokale për Siguri Publike
MAPL	Ministria e Pushtetit Lokal
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
OJQ	Organizata joqeveritare
PKIE	Programi Kombëtar Për Integrim Evropian

Hyrje

Ky raport paraqet implementimin e obligimeve të komunave, që burojnë nga Agjenda Evropiane gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2024. Duke pasur parasysh se Programi Kombëtar i Zbatimit të MSA është dokument ligjërish i detyrueshëm për të gjitha Institucionet e Kosovës, Ministria Administrimit të Pushtetit Lokal është e përkushtuar në përbushjen e obligimeve të komunave që dalin nga Agjenda Evropiane.

Me qëllim të koordinimit të aktiviteteve, MAPL ka zhvilluar disa mënyra të adresimit të çështjeve në nivel lokal për të shtyrë para agjendën evropiane, duke veçuar: koordinimin e procesit të planifikimit, hartimin e planit të përgjithshme për obligimet e komunave në procesin e integritetit evropian, hartimin e planeve individuale të komunave si dhe hartimin e raportit të përbushjes së obligimeve të komunave që dalin nga Agjenda Evropiane për periudhën Janar – Dhjetor 2024.

Raporti ka rol të rëndësishëm dhe domethënës mbi zhvillimin e aktiviteteve të nivelit lokal në fushën e Integritetit Evropian, marrë parasysh përgjegjësinë që kanë komunat në raport me qytetarët dhe institucionet publike. Qëllimi i këtij raporti është prezantimi dhe ofrimi i të dhënave të komunave për qytetarët, institucionet vendore dhe ndërkombëtare, organizatat joqeveritare si dhe çdo grupi tjetër të interesit, bazuar në kriteret e përcaktuara nga Bashkimi Evropian.

Përmbledhje Ekzekutive

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2024 kanë raportuar 31 komuna të Republikës së Kosovës, ndërsa 7 komuna (Gjakovë, Istog, Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok, Mamushë, Kllokot) gjatë kësaj periudhe nuk kanë raportuar. Raporti është i bazuar në 55 veprime/masa dhe 177 pyetje/indikator që bien në përgjegjësi dhe kompetencë të komunave, për të cilat Ministria Administrimit të Pushtetit Lokal ka kërkuar veprime konkrete nga komunat. MAPL në komuna ka adresuar të gjitha çështjet që burojnë nga PKIE, nga konkluzionet e nën komiteteve sektoriale si dhe nga sfidat e raportit të KE-së për Kosovën. Sa i përket strukturës së gjithmbarshme, raporti përqendrohet në fushat kryesore të aktiviteteve të cilat kanë të bëjnë me kriteret politike, kriteret ekonomike, standardet evropiane si dhe raporti pasqyron gjendjen reale të arriturve të komunave, por njëkohësisht edhe të sfidave për vitet në vijim.

Në kuadër të **kritereve politike** prezantohet arritja e nivelit lokal në fushat:

- Administrata publike,
- Avokati i popullit,
- Shoqëria civile,
- Lufta kundër terrorizmit,
- Mbrojtja dhe trashëgimia kulturore.

Bazuar në të dhënat e ofruar nga komunat, gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2024 komunat e Republikës së Kosovës kanë arritur t'i përbushin përafërsisht **54.0%** të aktiviteteve të planifikuara në fushën e kritereve politike.

Në kuadër të **kritereve ekonomike** prezantohet arritja e nivelit lokal në fushat:

- Ekzistenca e ekonomisë funksionale e tregut,
- Tatimet,
- Ndërmarrjet, politikat e industrisë dhe tregu i brendshëm.


Bazuar në të dhënat e ofruar nga komunat, gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2024 komunat e Republikës së Kosovës kanë arritur t'i përbushin përafërsisht **76.0%** të aktiviteteve të planifikuara në fushën e kritereve ekonomike.

Në kuadër të **standardeve evropiane**, prezantohet arritja e nivelit lokal në fushat:

- Bujqësi dhe zhvillimi rural,
- Energji,
- Gjyqësori dhe të drejtat themelore, mbrojtja e minoriteteve,
- Drejtësi,
- Liria dhe siguria,
- Menaxhimi i kufirit dhe migracioni,
- Arsimi dhe Kultura,
- Mjedisi dhe mbrojtja e konsumatorit dhe shëndetit publik.

Bazuar në të dhënat e ofruar nga komunat, gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2024 komunat e Republikës së Kosovës kanë arritur t'i përmbushin përafërsisht **62% të** aktiviteteve të planifikuara në fushën e standardeve evropiane.

Në total komunat kanë arritur t'i përmbushin përafërsisht **64%** të obligimeve që burojnë nga Agjenda Evropiane, e që bien nën përgjegjësinë e implementimit të qeverisjes lokale.



Grafikoni 1: Përmbushja e obligimeve të komunave nga Agjenda Evropiane


1. KRITERET POLITIKE

1.1 Administrata Publike

Një nga fushat kryesore që bënë pjesë në kuadër të kriterëve politike është funksionimi i administratës publike lokale. Në kuadër të kësaj fushe, komunat e Republikës së Kosovës kanë ndërmarr aktivitete lidhur me sigurimin e kapaciteteve të nevojshme për administratën lokale, rritjen e cilësisë së shërbimeve publike për qytetarë, rritjen e efikasitetit dhe transparencës, si dhe ndërtimin e mekanizmave më efikas të llogaridhënies në raport me qytetarët.

Në kuadër të masave për ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore, Në **25** komuna (Pejë, Junik, Prizren, Gllogoc, Rahovec, Dragash, Prishtinë, Klinë, Kaçanik, Hani i Elezit, Skenderaj, Graçanicë, Mitrovica e Jugut, Shtime, Malishevë, Viti, Partesh, Gjilan, Ferizaj, Vushtrri, Suharekë, Novobërde, Lipjan, Kamenicë, Fushe Kosovë) kanë hartuar programin e trajnimeve për vitin 2024, ndërsa **6** komuna (Shtërpçë, Deçan, Podujevë, Ranillug, Mitrovica e Veriut, Obiliq) nuk e kanë hartuar këtë program për periudhën raportuese.

Me qëllim të përmirësimit të mëtejshëm të kornizës së politikave në fushën e administratës, në pasqyrën e të dhënave të komunave mund të shohim se nga 31 komuna raportuese janë 18 komuna (Pejë, Junik, Prizren, Deçan, Rahovec, Prishtinë, Klinë, Kaçanik, Hani i Elezit, Skenderaj, Graçanicë, Shtime, Malishevë, Partesh, Gjilan, Ferizaj, Suharekë, Lipjan) kanë hartuar Strategjinë për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun, ndërsa 13 komuna (Shtërpçë, Gllogoc, Dragash, Mitrovica e Jugut, Podujevë, Viti, Ranillug, Mitrovica e Veriut, Vushtrri, Novobërdë, Fushë Kosovë, Kamenicë, Obiliq) nuk e kanë hartuar këtë dokument.



Grafikoni 2: Programit i trajnimeve dhe Strategjia për Komunikim me Publikun

Po ashtu planin vjetor të komunikimit deri më tani 23 komuna (Pejë, Junik, Prizren, Glogoc, Deçan, Rahovec, Klinë, Kaçanik, Hani i Elezit, Mitrovica e Jugut, Shtime, Malishevë, Podujevë, Viti, Ranillug, Partesh, Gjilan, Ferizaj, Vushtrri, Obiliq, Suhareke, Lipjan, Kamenicë) e kanë hartuar, ndërsa në 8 komuna (Shtërpçë, Dragash, Prishtinë, Skenderaj, Graçanicë, Mitrovica e Veriut, Novobërdë, Fushë Kosovë) ende nuk kanë hartuar.

Sa i përket zbatimit të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik, janë 28 komuna (Pejë, Junik, Shtërpçë, Prizren, Glogoc, Deçan, Rahovec, Dragash, Klinë, Kaçanik, Hani i Elezit, Skenderaj, Graçanicë, Mitrovica e Jugut, Shtime, Malishevë, Podujevë, Ranillug, Partesh, Gjilan, Ferizaj, Vushtrri, Obiliq, Suhareke, Novobërdë, Lipjan, Fushë Kosovë, Kamenicë) Ndërsa 1 komunë (Prishtinë) e zbaton pjesërisht dhe 2 komuna (Viti, Mitrovica e Veriut) nuk e zbatojnë. Mirëpo nëse shohim të dhënat e paraqitura në vijim mund të vërejmë që akoma nuk zbatohen dispozitat e U.A në nivel të duhur pasi që rezultatet e konsultimit publik me raportin e të gjitha propozimeve të ofruara nga qytetarët me sqarimet e nevojshme lidhur me arsyet e refuzimit të kërkesave të qytetarëve apo grupeve tjera të interesit publikohen në një numër të konsiderueshëm të Komunave.

Udhëzim Administrativ (MAPL) nr. 06/2018 për standardet minimale të konsultimit përcakton se në çdo komunë, përgjegjës për koordinimin e procesit të konsultimit publik është njësi/zyrtari për komunikim publik, në përputhje me këtë deri më tani 28 komuna (Pejë, Junik, Shtërpçë, Prizren, Glogoc, Rahovec, Dragash, Prishtinë, Klinë, Kaçanik, Hani i Elezit, Skenderaj, Graçanicë, Mitrovica e Jugut, Shtime, Malishevë, Podujevë, Viti, Partesh, Gjilan, Ferizaj, Vushtrri, Obiliq, Suhareke, Novobërdë, Lipjan, Fushë Kosovë, Kamenicë), të cilat kanë caktuar zyrtarin përgjegjës për koordinimin e procesit të konsultimit publik në komunë, ndërsa në 3 Komunë (Deçan, Ranillug, Mitrovica e Veriut) ende nuk është caktuar zyrtarin përgjegjës për koordinimin e procesit të konsultimit publik.

1.2 Shoqëria civile

Nga të dhënat e ofruara gjatë raportimit shohim se komunat në vazhdimësi kanë përkrahur shoqërinë civile duke i ofruar mbështetje dhe bashkëpunim. Nga të dhënat e pranuar një numër i konsiderueshëm i komunave kanë ofruar mbështetje financiare për projektet e OJQ-ve. 26 komuna (Prishtina, Rahoveci, Glllogoci, Viti, Graçanicë, Skenderaj, Peja, Shtime, Podujeva, Prizreni, Deçani, Malisheva, Klina, Shtërpca, Hani i Elezit, Mitrovica e Jugut, Dragashi, Juniku, Gjilani, Vushtrria, Obiliqi, Suhareka, Novobërda, Lipjani, Fushë Kosova, Kamenica) buxheti i ndarë për mbështetjen e projekteve të OSHC-ve konform Rregullores 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publikë të OJQ-ve është 9,634,249.02 mijë euro, ndërsa në 4 Komuna (Ranillug, Partesh, Mitrovica e Veriut, Obiliq) nuk ka ndarë buxhet, dhe 1 komunë (Kaçanik) nuk ka ofruar të dhëna. Me këtë mbështetje financiare janë përkrahur OJQ me 1,211 projekte.

Për nxitjen dhe stimulimin e aplikimit të OJQ-ve në projekte komunale komunat kanë ndërmarr edhe veprime si: informimi në radio lokale, rrjete sociale dhe thirrje në ueb faqe të komunave, organizime të takimeve informuese për procedurat e aplikimit, ofrimi i ndihmës në plotësimin e dokumentacionit aplikues për gupet e OJQ-ve të cilat janë të marginalizuara, etj. Komunat gjithashtu kanë përkrahur edhe projekte të OJQ-ve për mbrojtjen e komuniteteve pakicë. Në 14 Komuna (Pejë, Shtërpçë, Prizren, Dragash, Prishtinë, Graçanicë, Shtime, Gjilan, Ferizaj, Vushtrri, Obiliq, Lipjan, Fushë Kosovë, Kamenicë) janë përkrahur 28 projekte të OJQ-ve për mbrojtjen e komuniteteve pakicë në vlerë prej 220,250.00 mijë euro.

Në 25 komuna (Pejë, Junik, Shtërpçë, Prizren, Glllogoc, Deçan, Rahovec, Dragash, Prishtinë, Klinë, Kaçanik, Hani i Elezit, Skenderaj, Graçanicë, Mitrovicë e Jugut, Shtime, Podujevë, Viti, Gjilan, Ferizaj, Vushtrri, Suharekë, Lipjan, Fushë Kosovë, Kamenicë) është bërë publikimi i thirrjeve dhe përfituesve në web faqet. Në 4 komuna (Malishevë, Partesh, Mitrovicë e Veriut, Obiliq) nuk e kanë bërë. Për 2 Komuna (Ranillug, Novobërdë) nuk ka të dhëna.

1.3 Lufta kundër korrupsionit dhe kundër terrorizmit

Një ndër objektivat më specifike e cila buron nga Strategjia për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që shpie në terrorizëm është edhe ngritja e kapaciteteve të institucioneve me qëllim të identifikimit të hershëm të faktorëve dhe proceseve të radikalizmit, andaj me këtë qëllim në 11 komuna (Junik, Glllogoc, Deçan, Mitrovicë e Jugut, Malishevë, Podujevë, Partesh, Gjilan, Vushtrri, Obiliq, Lipjan) në bashkëpunim nivelin qendror dhe donatorë janë organizuar trajnime për zyrtarët komunal të arsimit, mësuesit, dhe menaxhmentin e shkollave për të identifikuar të rinjtë që janë në rrezik për ekstremizëm kurse në 20 komuna (Pejë, Shtërpçë, Prizren, Rahovec, Dragash, Prishtinë, Klinë, Kaçanik, Hani i Elezit, Skenderaj, Graçanicë, Shtime, Viti, Ranillug, Mitrovicë e Veriut, Ferizaj, Suharekë, Novobërdë, Fushë Kosovë, Kamenicë) nuk janë organizuar.


Për mbështetjen dhe parandalimin e luftës kundër terrorizmit, radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, janë 17 komuna që kanë ndërmarrë veprime konkrete për vetëdijesimin e qytetarëve kundër radikalizmit që mund të shpijë në ekstremizëm të dhunshëm si: takime të rregullta përmes këshillave lokale dhe imamëve të xhamive lokale, takime me nxënës të shkollave të ndryshme, janë krijuar hapësirat e sigurt në shkolla për nxënës që të bëjnë pyetje privatisht rreth çështjeve të ndjeshme sociale, fushata vetëdijesuese me qytetarët, aktivitete në terren, diskutime gjatë takimeve të rregullta me anëtarët e KKS-së, takime me rinin, gra dhe strukturat arsimore

me qëllim të identifikimit të faktorëve që ndikojnë në rritjen e ekstremizmit me radikalizëm etj, ndërsa 14 komuna (Pejë, Shtërpçë, Rahovec, Dragash, Prishtinë, Klinë, Kaçanik, Ranillug, Mitrovica e Veriut, Shtime, Ferizaj, Suharekë, Novobërdë, Fushë Kosovë) nuk janë ndërmarrë veprime. Në 30 komuna nuk ka pasur asnjë rast të paraqitur në Këshillat Komunal të Sigurisë në Bashkësi lidhur me ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin, ndërsa 1 Komunë (Gjilan) është paraqitur 1 rast.

Më qëllim të luftimit të korrupsionit, komunat në vazhdimësi në rast të konfliktit të interesit nga zyrtarët komunal kanë deklaruar rastet e konfliktit të interesit. Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2024, në 26 komuna nuk ka pasur asnjë rast të konfliktit të interesit nga zyrtarët komunal. Në 5 Komuna (Glogoc, Prishtinë, Klinë, Podujevë, Vushtrri) janë paraqitur 12 raste të raportuar të konfliktit të interesit nga zyrtarët.

Sa i përket anëtarëve të kuvendit, që kanë deklaruar konfliktin e interesit para marrjes së vendimeve në kuvend të komunës në 3 komuna (Rahovec, Klinë, Vushtrri) janë paraqitur 36 raste, ndërsa në 28 Komuna nuk ka pasur raste të tilla.

Plani Lokal për Integritet është hartuar në 27 komuna ndërsa në 4 komuna (Graçanicë, Mitrovica e Veriut, Ferizaj, Fushë Kosovë) nuk është hartuar Plani Lokal për Integritet. Pjesa më e madhe e komunave sipas raportimeve e kanë të caktuar zyrtarin që raporton për Planin Lokal të Integritetit nga 31 komuna raportuese 27 komuna kanë caktuar zyrtarin përkatës, ndërsa 4 komuna (Shtërpçë, Ranillug, Mitrovica e Veriut, Fushë Kosovë) nuk e kanë caktuar ende zyrtarin.



Grafikoni 3: Plani Lokal për Integritet dhe zyrtari i caktuar për planin e integritetit

Sa i përket implementimit të Ligjit për përdorimin e gjuhëve, për krijimin e qasjes për shërbimin në gjuhët zyrtare janë 22 komuna të cilat kanë ndërmarr veprimet si: *organizim i trajnimeve, kurse për gjuhën serbe dhe shqipe, janë punësuar zyrtarë për përkthim, ofrohen shërbime simulante nëpër të gjitha takimet zyrtare, materialet e organeve komunale përkthehen të gjitha në gjuhë zyrtare, shpërndahen broshura të ndryshme për promovimin e të drejtave gjuhësore për të gjitha komunitete* etj ndërsa 5 komuna (Skenderaj, Shtime, Podujevë, Mitrovicë e Veriut, Gjilan) nuk kanë ndërmarr

veprime, Në 4 komuna (Klinë, Malishevë, Ranillug, Partesh) janë ndërmarrë veprime të pjesshme ose janë në proces të përmirësimit të kësaj çështjeje. Ashtu siç parashihet në Ligjin për përdorimin e gjuhëve si dhe në rregulloret komunale për gjuhët zyrtare, në 27 komuna bëhet publikimi i akteve komunale në gjuhët zyrtare, ndërsa në 4 Komuna (Hani Elezit, Skenderaj, Mitrovica e Veriut, Gjilan) nuk publikohen.

1.4 Mbrojtja dhe trashëgimia kulturore

Në fushën e trashëgimisë kulturore sfidë e komunave vazhdon ende të mbetet hartimi i planeve komunale për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, pasi që sipas të dhënave nga 31 komuna raportuese të komunave janë vetëm 10 komuna (Shtërpçë, Prizreni, Deçani, Dragashi, Prishtina, Graçanicë, Kaçanik, Viti, Obiliq, Rahoveci) të cilat kanë hartuar këtë plan.

Sfidat që 21 komuna (Pejë, Juniku, Glllogoc, Malisheve, Podujeva, Partesh, Ranillug, Ferizaj, Suharekë, Novobërdë, Mitrovica Jugore, Hani Elezit, Skenderaj, Shtime, Gjilan, Vushtrri, Lipjan, Fushë Kosovë, Kamenicë, Mitrovicë Veriore, dhe Klinë) nuk e kanë miratuar këtë Plan janë: Mungesa e stafit profesional, mungesa e ekspertëve, mungesa e mjeteve buxhetore, sfidat lidhur me regjistrimin dhe dokumentimin e trashëgimisë kulturore ekzistuese etj.

Numri i shkeljeve dhe ndërtimeve ilegale në 4 Komuna (Shtërpçë 15 shkelje, Prizren 1 Shkelje, Mitrovica Jugore 1 shkelje, Lipjan 2 shkelje) janë evidentuar shkelje në zonat e mbrojtura, ndërsa në 20 Komuna (Peja, Junik, Glllogoc, Deçan, Dragash, Kaçanik, Shtime, Malisheve, Podujeva, Viti, Partesh, Ranillug, Gjilan, Ferizaj, Vushtrri, Obiliq, Suharekë, Novobërdë, Fushë Kosovë, Kamenicë) nuk ka pasur raste, në 6 Komuna (Rahovec, Prishtinë, Hani Elezit, Graçanicë, Klinë, Skenderaj) nuk kanë ofruar përgjigje dhe 1 Komunë (Mitrovicës Veriore) nuk ka informacion.

Në 8 Komuna (Glllogoc, Shtime, Malisheve, Partesh, Ranillug, Mitrovicë e Veriut, Partesh, Vushtrri) nuk janë siguruar pajisjet për monitorimin e sigurisë/instalimi i kamerave të tërësive të objekteve të trashëgimisë kulturore (objektet e kultit fetar, zonat e mbrojtura, muzetë, etj, në 12 Komuna (Pejë, Junik, Shtërpçë, Prizren, Deçan, Klinë, Gjilan, Ferizaj, Obiliq, Suharekë, Lipjan, Fushë Kosovë) janë siguruar këto pajisje, dhe në 10 Komunë (Dragash, Kaçanik, Mitrovica Jugore, Prizren, Rahovec, Dragash, Prishtinë, Podujevë, Viti, Novobërdë, Kamenicë) janë siguruar pjesërisht. Në 1 Komunë (Hani Elezit) nuk ka kisha .

Në 5 komuna (Shtërpçë, Klinë, Partesh, Ferizaj, Fushë Kosovë) janë nënshkruar Memorandume të bashkëpunimit për detyrat dhe përgjegjësitë për mirëmbajtjen e Kishave Ortodokse. Në 20 Komuna (Pejë, Junik, Prizren, Glllogoc, Deçan, Mitrovica Jugore, Shtime, Podujevë, Viti, Ranillug, Mitrovicë e Veriut, Partesh, Vushtrri, Obiliq, Novobërdë, Lipjan, Kamenicë, Dragash, Kaçanik, Malishevë) nuk janë nënshkruar sepse disa prej tyre nuk kanë kisha. Ndërsa 6 Komuna (Rahovec, Prishtina, Hani Elezit, Graçanicë, Gjilan, Suharekë) nuk kanë ofruar të dhëna.

Për funksionimin e Këshillit të fshatit për Hoqën e Madhe, komuna e Rahovecit i ka përfunduar me kohë të gjitha procedurat për themelimin e këtij këshilli. Ky këshill është funksional dhe është ndarë buxhet për të mundësuar funksionimin e tij për vitin 2025 në vlerë prej 30.670 mijë euro.

Për zbatimin e Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit, për periudhën Janar-Dhjetor 2024 komuna e Prizrenit nuk ka alokuar buxhet, ka pasur 3 ndërtime ilegale brenda Zonave të Veçanta të Mbrojtura në Komunën e

Prizrenit, prej tyre 1 ndërtim, 1 rrënim dhe 1 renovim. Është bërë trajtimi i objekteve pa leje konform ligjit për legalizim. Është bërë klasifikimi i kërkesave për legalizim.

Në Komunën e Fushë Kosovës nuk është bërë themelimi Muzeut të Natyrës.

Gjithashtu me qëllim për ndërgjegjësimin dhe promovimin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore komunat kanë ndërmarrë aktivitetet të ndryshme. Në 22 Komuna (Pejë, Junik, Prizren, Glogoc, Deçan, Rahovec, Prishtinë, Klinë, Kaçanik, Mitrovicë Jugore, Malishevë, Podujevë, Viti, Partesh, Gjilan, Ferizaj, Vushtrri, Obiliq, Suharekë, Lipjan, Fushë Kosovë, Kamenicë) janë realizuar këto aktivitete: *Promovimi i asetëve të trashëgimisë në media televizive, Postimit e fotografive nga asetet e trashëgimisë kulturore, Është bërë projekti për restaurimin e disa objekteve të trashëgimisë kulturore, Pastrimi i qytetit, shpërndarja e broshurave, vetëdijësimi i qytetarëve, restaurimeve, aktiviteteve edukative, ekspozitave dhe projekteve kulturore, hartimi i hartave zonale dhe broshurave për promovim të turizmit, vizita të ndryshme në objektet që janë nën mbrojtje* etj, ndërsa në 9 Komuna (Shtërpçë, Dragash, Hani Elezit, Skenderaj, Graçanicë, Shtime, Ranillug, Mitrovicë e Veriut, Novobërdë) nuk janë mbajtur aktivitete.

2. KRITERET EKONOMIKE

2.1 Ekzistenca e ekonomisë funksionale e tregut

Për ofrimin e shërbimeve më të mira për qytetarët është paraparë krijimi i qendrave për regjistrimin e bizneseve (one stop shop-et) të cilat lehtësojnë ofrimin e shërbimeve për biznese përfshirë regjistrimet e tyre. Në 28 komuna janë funksionale, ndërsa në 3 Komuna (Prishtinë, Ranillug, Partesh) nuk janë themeluar.

Numri i inspektorëve të tregut në 25 komuna është 33, ndërsa janë 6 Komuna (Pejë, Junik, Shtërpçë, Prishtinë, Mitrovicë e Veriut, Novobërdë) nuk kanë inspektor. Gjithashtu numri i inspektimeve në 25 komuna është 10,331 inspektime, ndërsa 5 Komuna (Pejë, Shtërpçë, Prishtinë, Shtime, Novobërdë) nuk ka pasur inspektime. Ndërsa në 1 Komunë (Klinë) nuk ka të dhëna.

Sa i përket dëgjimeve publike për planifikimin e buxhetit në 27 komuna janë mbajtur 187 dëgjime publike, kurse në 3 komuna (Pejë, Graçanicë, Shtime) nuk janë mbajtur, ndërsa në 1 komunë (Hani i Elezit) nuk është ofruar përgjigje.

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2024 në 27 Komuna numri i bizneseve të regjistruara është 6,951 biznese, Komuna e Prishtinës nuk ka ofruar të dhëna për bizneset e regjistruara në këtë periudhë të raportimit. Ndërsa numri i bizneseve të mbyllura në gjashtëmujorin e parë të vitit në 27 Komuna është 522 biznese, në 1 Komunë (Junik) nuk ka pasur biznese të mbyllura si dhe 4 Komuna (Prishtina, Lipjani, Obiliq, Novobërdë) nuk ka ofruar të dhëna. Një ndër aktivitetet të cilat kanë rëndësi në agjendën Evropiane është edhe mbështetja e Grave në udhëheqjen e bizneseve, e që gjatë vitit 2024 numri i bizneseve të udhëhequra nga gratë në 26 Komuna (Pejë, Junik, Shtërpçë, Prizren, Glogoc, Deçan, Rahovec, Dragash, Klinë, Kaçanik, Hani Elezit, Skenderaj, Mitrovicë Jug, Shtime, Malishevë, Podujevë, Ranillug, Mitrovicë e Veriut, Partesh, Gjilan, Ferizaj, Vushtrri, Suhareka, Lipjan, Fushë Kosovë, Kamenica) është 4,398 biznese, ndërsa në 5 Komuna (Prishtina, Obiliq, Novobërda, Graçanicë dhe Viti) nuk ka biznese të udhëhequra nga gratë.

Buxheti i ndarë në 12 Komuna (Pejë, Glogoc, Kaçanik, Hani Elezit, Skenderaj, Mitrovicë Jugore, Malishevë, Podujevë, Gjiilan, Ferizaj, Kamenicë, Fushë Kosovë) për subvencionimin e bizneseve është 797,200.00 mijë euro, ndërsa në 19 Komuna (Junik, Shtërpçë, Prizren, Deçan, Rahovec, Dragash, Prishtinë, Klinë, Graçanicë, Shtime, Viti, Ranillug, Partesh, Mitrovicë e Veriut, Vushtrri, Obiliq, Suharekë, Novobërdë, Lipjan) nuk kanë ndarë buxhet për subvencionimin e bizneseve gjatë periudhës raportuese.

2.2 Tatimet

Me qëllim të luftimit të ekonomisë jo formale në 26 komuna janë ndërmarr veprime si: *kontrollat e vazhdueshme tek bizneset lidhur me lëshimin e kuponëve fiskal, Mbyllja e subjekteve ilegale deri në kompletimin e dokumentacionit adekuat për ushtrimin e veprimtarisë, Obligimi i bizneseve për tu regjistruar pranë ARBK, produkteve të cilat kanë qenë pa deklaracion në gjubën zyrtare janë larguar nga shitja kurse produktet që kanë qenë pa origjinë janë sekuestruar dhe asgjësuar në prani të personave që kanë bërë tregtimin e tyre në mënyrë të pa ligjshme, vërejtje, inspektime mbi posedimin certifikatave të regjistrimit të bizneseve, inspektim dhe kontrole të vazhdueshme të lokaleve afariste, mbyllja e subjekteve ilegale, ofrimi i këshillave të nevojshme për të operuar ligjshëm etj* ndërsa në 5 komuna (Shtërpçë, Shtime, Ranillug, Prishtinë, Novobërdë) nuk është ndërmarr asnjë veprim.

Gjatë periudhës vitit 2024, nga 31 komuna raportuese 25 prej tyre kanë pranuar 233 rekomandime nga Auditori i Përgjithshëm. Prej tyre të adresuar janë 173 rekomandime, të pa adresuara mbasin 80 rekomandime dhe 104 rekomandime gjenden në proces.

Njësia e Auditimit të Brendshëm është e funksionalizuar në 26 komuna, ndërsa 5 komuna (Mitrovicë Veriore, Partesh, Hani i Elezit, Graçanicë, Ranillug) nuk funksionon.

Në 24 Komuna (Pejë, Junik, Shtërpçë, Prizren, Glogoc, Deçan, Rahovec, Dragash, Prishtinë, Klinë, Kaçanik, Skenderaj, Graçanicë, Mitrovicë Jug, Shtime, Malishevë, Podujevë, Viti, Gjiilan, Ferizaj, Vushtrri, Obiliq, Suharekë, Kamenicë) është themeluar komiteti për auditim, ndërsa në 7 Komuna (Partesh, Mitrovicë e Veriut, Novobërdë, Lipjan, Fushë Kosovë, Hani i Elezit dhe Ranillug) nuk është themeluar.

Sa i përket planifikimit të pronës komunale për zhvillim ekonomik lokal, janë 25 komuna të cilat kanë publikuar regjistrin e pronës komunale, ndërsa në 6 komuna (Prizren, Deçan, Partesh, Mitrovicë e Veriut, Obiliq, Graçanicë) nuk është publikuar.

2.3 Ndërmarrjet dhe politikat e industrisë

Në 11 komuna është bërë funksionalizimi i zonave ekonomike, Në 20 Komuna (Pejë, Prizren, Deçan, Rahovec, Prishtinë, Klinë, Kaçanik, Hani i Elezit, Shtime, Malishevë, Podujevë, Ranillug, Partesh, Mitrovicë e Veriut, Gjiilan, Ferizaj, Vushtrri, Novobërdë, Fushë Kosovë, Graçanicë) nuk është bërë ende funksionalizimi i zonave ekonomike.

3. STANDARDET EVROPIANE

3.1 Bujqësia dhe zhvillimi rural

Në sektorin e bujqësisë sfidë e theksuar mbetet hartimi i dokumenteve për rregullimin e mëtejshëm të tokave bujqësore pasi që nga 31 Komuna raportuese vetëm në 11 komuna (Junik, Prizren, Glllogoc, Rahovec, Dragash, Hani i Elezit, Malishevë, Podujevë, Partesh, Ferizaj, Kamenicë) është hartuar Plan Programi për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, ndërsa në 20 komuna (Pejë, Shtërpçë, Deçan, Prishtinë, Klinë, Kaçanik, Skenderaj, Mitrovicë Jug, Shtime, Viti, Ranillug, Mitrovicë e Veriut, Gjilan, Vushtrri, Obiliq, Suharekë, Novobërdë, Lipjan, Fushë Kosovë, Graçanicë) ende nuk është hartuar Plan Programi për Bujqësi dhe Zhvillim Rural. Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2024 në 22 komuna (Pejë, Junik, Shtërpçë, Glllogoc, Deçan, Rahovec, Prishtinë, Klinë, Kaçanik, Hani Elezit, Skenderaj, Mitrovicë Jug, Shtime, Malishevë, Podujevë, Viti, Ranillug, Partesh, Gjilan, Ferizaj, Novobërdë, Fushë Kosovë) numri i kërkesave të parashtruara për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore është 501, ndërsa 9 komuna (Shtërpçë, Prizren, Dragash, Vushtrri, Obiliq, Suharekë, Lipjan, Kamenicë, Graçanicë) nuk ka pasur kërkesa të parashtruara. Krahas kësaj lidhur me këto kërkesa janë nxjerr 394 vendime nga 22 komuna (Pejë, Junik, Glllogoc, Deçan, Rahovec, Prishtinë, Kaçanik, Hani Elezit, Skenderaj, Mitrovicë Jug, Shtime, Malishevë, Podujevë, Viti, Ranillug, Partesh, Gjilan, Ferizaj, Novobërdë, Lipjan, Fushë Kosovë, Kamenicë), ndërsa në 9 komuna (Shtërpçë, Prizren, Dragash, Klinë, Graçanicë, Mitrovicë e Veriut, Vushtrri, Obiliq, Suharekë) nuk ka pasur asnjë vendim të miratuar.

Në 10 Komuna (Pejë, Prizren, Glllogoc, Rahovec, Dragash, Klinë, Ranillug, Partesh, Kamenicë, Fushë Kosovë) ka pasur raste të humbjes së tokës bujqësore, ndërsa në 14 Komuna (Junik, Shtërpçë, Deçan, Hani i Elezit, Mitrovicë Jug, Shtime, Malishevë, Podujevë, Viti, Gjilan, Ferizaj, Vushtrri, Suharekë, Lipjan) nuk ka pasur raste, dhe 7 komuna (Prishtinë, Kaçanik, Skenderaj, Graçanicë, Mitrovicë e Veriut, Obiliq, Novobërda) nuk ka ofruar të dhëna.

Në komunat të cilat ka pasur raste të humbjes së tokës bujqësore është ndërtuar shtrati i lumit, janë kryer insptime, është bërë ndërprerja e ndërrimit të destinimit të tokës bujqësor në tokë ndërtimore dhe ka pasur gjoba.

Lidhur me konsolidimin e mëtejshëm të qendrave informative këshilluese komunale për bujqësi dhe zhvillim rural në 22 komuna (Pejë, Junik, Glllogoc, Deçan, Rahovec, Dragash, Prishtinë, Klinë, Kaçanik, Skenderaj, Mitrovicë Jug, Viti, Partesh, Gjilan, Ferizaj, Vushtrri, Obiliq, Suharekë, Novobërdë, Lipjan, Fushë Kosovë, Kamenicë) janë funksionalizuar këto qendra. Në 9 komuna (Shtërpçë, Prizren, Hani i Elezit, Shtime, Malishevë, Podujevë, Ranillug, Graçanicë, Mitrovicë e Veriut) nuk janë funksionalizuar.

Për mbrojtjen e tokave bujqësore dhe promovimin e rëndësisë së tokave bujqësore, në 22 komuna (Glllogoc, Suharekë, Junik, Pejë, Dragash, Podujevë, Skenderaj, Klinë, Kaçanik, Kamenicë, Malishevë, Rahovec, Shtime, Lipjan, Gjakovë, Mitrovicë e Jugut, Prishtinë, Gjilan, Obiliq, Ranillug, Viti, Ferizaj) është ofruar mbështetje për 7,879 fermer në sektorin e bletarisë, blegtorisë, perimtarisë, shpezetaris, hortikulturës, ndërsa 6 komuna (Shtërpçë, Deçan, Novobërdë, Lipjan, Graçanicë, Mitrovicë e Veriut) nuk janë mbështetur.

Planin për Menaxhimin e tokave rurale e posedojnë 16 komuna (Pejë, Dragash, Hani Elezit, Graçanicë, Shtime, Podujevë, Viti, Partesh, Gjilan, Ferizaj, Vushtrri, Obiliq, Suharekë, Novobërdë, Lipjan, Fushë Kosovë). Në 15

komuna (Junik, Shtërpçë, Prizren, Glogoc, Deçan, Rahovec, Prishtinë, Klinë, Kaçanik, Skenderaj, Mitrovicë Jug, Malishevë, Ranillug, Kamenicë, Mitrovice e Veriut) nuk është hartuar.


3.2 Energjia

Me qëllim të zbatimit të obligimeve të dala nga MSA komunat në vazhdimësi kanë bërë zhvillime të mëtejme në politikat e fushës së efikasitetit të energjisë. Planin për Efikasitet të Energjisë e kanë hartuar 16 komuna (Pejë, Junik, Shtërpçë, Prizren, Glogoc, Deçan, Rahovec, Dragash, Malishevë, Viti, Partesh, Ferizaj, Obiliq, Suharekë, Novobërdë, Lipjan), ndërsa në 15 komuna (Prishtinë, Klinë, Kaçanik, Skenderaj, Graçanicë, Mitrovicë Jugore, Shtime, Podujevë, Ranillug, Mitrovicë e Veriut, Gjilan, Vushtrri, Fushë Kosovë, Kamenicë, Hani i Elezit) ende nuk është hartuar ky Plan.

Me qëllim të zbatimit të këtij plani, në 21 komuna (Pejë, Junik, Shtërpçë, Prizren, Glogoc, Rahovec, Dragash, Prishtinë, Klinë, Kaçanik, Skenderaj, Mitrovicë Jug, Malishevë, Podujevë, Viti, Gjilan, Ferizaj, Obiliq, Suharekë, Lipjan, Kamenicë) ka pasur projekte në masat e zbatimit të efikasitetit. Disa nga projektet janë: Vendosija e poqeve eficient në qytet dhe në fshatra, Izolimi i objekteve arsimore dhe objekteve të tjera publike me masat për efikasitet të energjisë, Ndërimi i trupave ndriquese me trupa eficientë – LED, ndërtimi i sistemeve të reja të ngrohjes qendrore nëpër objektet publike etj. Në 10 komuna (Deçan, Hani i Elezit, Graçanicë, Shtime, Ranillug, Partesh, Mitrovice e Veriut, Vushtrri, Novobërdë, Fushë Kosovë) nuk ka pasur asnjë projekt.

Gjyqësori dhe të drejtat themelore

Në kuadër të ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi komunat janë të obliguar të caktojnë njësinë apo zyrtarin përkatës për të koordinuar dhe raportuar zbatimin e këtij ligji dhe sipas të dhënave zyrtare mund të shohim se deri më tani në 25 komuna (Pejë, Junik, Shtërpçë, Prizren, Glogoc, Deçan, Rahovec, Dragash, Prishtinë, Klinë, Hani i Elezit, Skenderaj, Graçanicë, Mitrovicë Jug, Shtime, Malishevë, Podujevë, Ranillug, Partesh, Ferizaj, Vushtrri, Suharekë, Lipjan, Fushë Kosovë, Kamenicë) është emëruar zyrtari përkatës për mbrojtjen e diskriminimit, ndërsa në 6 komuna (Kaçanik, Viti, Mitrovicë e Veriut, Gjilan, Obiliq, Novobërdë) nuk është emëruar. Sa i përket zyrtarit për barazi gjinore është caktuar në 27 komuna (Pejë, Junik, Shtërpçë, Prizren, Glogoc, Deçan, Rahovec, Dragash, Prishtinë, Klinë, Hani i Elezit, Skenderaj, Graçanicë, Mitrovicë Jug, Shtime, Malishevë, Podujevë, Viti, Partesh, Mitrovicë e Veriut, Gjilan, Ferizaj, Vushtrri, Suharekë, Lipjan, Fushë Kosovë, Kamenicë), ndërsa në 4 komuna (Kaçanik, Ranillug, Obiliq, Novobërdë) nuk është emëruar zyrtari përkatës.



Grafikoni 5: Caktimi i zyrtarëve për zbatimin e ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi dhe barazi gjinore

Në 14 komuna (Pejë, Rahovec, Prishtinë, Klinë, Kaçanik, Skenderaj, Graçanicë, Mitrovicë Jugore, Malishevë, Ranillug, Vushtrri, Obiliq, Lipjan, Fushë Kosovë) janë ndarë mjete buxhetore me shumë prej 103,140€ euro për zhvillimin e aktiviteteve në fushën e të drejtave të njeriut ndërsa në 17 komunat tjera (Junik, Shtërpçë, Prizren, Gillogoc, Deçan, Dragash, Shtime, Podujevë, Viti, Partesh, Mitrovicë e Veriut, Gjilan, Ferizaj, Suharekë, Novobërdë, Kamenicë, Hani i Elezit) nuk është ndarë buxhet.

Një ndër sfidat e evidentuara nga raporti i KE-së për Kosovën për nivelin lokal është kujdesi për të moshuarit mbetet një çështje serioze. Nga të dhënat e ofruara rezultojnë se në 10 komuna (Pejë, Rahovec, Prishtinë, Skenderaj, Shtime, Ferizaj, Vushtrri, Suharekë, Novobërdë, Lipjan) ofrojnë përkujdesje rezidenciale për të moshuarit, ndërsa 21 komuna (Junik, Shtërpçë, Prizren, Gillogoc, Deçan, Dragash, Klinë, Kaçanik, Graçanicë, Mitrovicë Jug, Malishevë, Podujevë, Viti, Ranillug, Partesh, Mitrovicë e Veriut, Gjilan, Obiliq, Fushë Kosovë, Kamenicë, Hani i Elezit) nuk ofrojnë përkujdesje rezidenciale për të moshuarit.

